

# **STATUTI**

## **i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar**

### **“ALBANIA NATURAL SUPPLEMENTS” SH.P.K.**

Parashikimet e ketij Statuti zbatohen per nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (SHPK).

Ne kete statut:

- “Ligji” eshte Ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i azhornuar;
- “Statuti” eshte Statuti i shoqerise;
- QKB” – Qendra Kombetare e Biznesit ne Shqiperi.

## **KREU I**

### **Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

#### **Neni 1**

##### **Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Me date 25.08.2023 ne te nenshkruarit: Benisa Kaçe e datelindjes 05.02.1975 e pajisur me pasaporten biometrike BB5738441, Roena Polena e datelindjes 09.06.1985 e pajisur me pasaporten amerikane 665105987, Sotiel Sam Polena i datelindjes 09.05.1983 i pajisur me pasaporten amerikane me numer 534837840, regjistrojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “Albania Natural Supplements” Shpk.

#### **Neni 2**

##### **Objekti**

2.1 Shoqëria oganizohet dhe funksionon duke ushtruar veprimtarinë e saj në fushën e tregëtise se suplementeve, vitaminave, mineraleve me baze ushqimore.

- Import – Eksport, Distribucion
- Shitje me shumice dhe pakice
- Shitje online
- Konsulence per perdorimin e suplementeve
- Siper marrje Franchisee
- Cdo veprimtari tjetër te lidhur me veprimtarine kryesore

dhe aktiviteteteve të tjera që lidhen indirekt me këtë fushë, me objekt të detajuar:

Gjithashtu shoqëria mund te ushtroje edhe çdo lloj aktiviteti tjetër te pashprehur me siper, qe lejohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja**

3.1. Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pacaktuar.

### **Neni 4**

#### **Selia**

4.1. Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen: Lagjia 2, Rruga Mihal Grameno, njesia administrative 2, nr. godine 210/1, kati 1, zona kadastrale 8190, numer pasurie 3/554-ND

## **KREU II**

### **Kapitali**

### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali fillestar i kompanise do te jete 100.000 (njqindmije) leke te ndare ne 3 kuota me vlere nominale 100.000 leke per kuote te cilat zoterohen si me poshte :

Benisa Kaçe zoteron 1 kuote qe perfaqeson 51% te kapitalit me vlere 51.000 leke.

Roena Polena zoteron 1 kuote qe perfaqeson 24.5 % te kapitalit me vlere 24.500 leke.

Sotiel Sam Polena zoteron 1 kuote qe perfaqeson 24.5 % te kapitalit me vlere 24.500 leke

5.2. Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

6.1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

6.2. Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

6.3. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

6.4. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

## **Neni 7**

### **Transferimi i kapitalit**

7.1. Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

7.3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

## **KREU III**

### **Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese**

## **Neni 8**

### **Organi Vendimmarres**

8.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

8.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

8.3. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat “c” dhe “ç” te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

8.4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

8.5. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

8.6. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

## **Neni 9**

### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

9.1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

9.2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortakët jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**

10.1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

10.2. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

10.3. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

11.1. Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

11.2. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si :

a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;

- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
  - c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
  - ç) percaktimin e shperblimeve
  - d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- 11.3. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyquar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## **Neni 12**

### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

12.1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

12.2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

## **Neni 13**

### **Administrimi**

13.1. Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripertesitjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

13.2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundertshtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

13.3. Znj. Benisa Kaçe eshte Administrator i shoqerise me afat 5 vjet, me te drejte ripertesitjeje.

## **Neni 14**

### **Kompetencat e Administratoreve**

14.1. Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;

ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;

d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;

e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

14.2. Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

14.3. Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

14.4. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marrredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## **Neni 15**

### **Pergjegjesite e Administratorit**

15.1. Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

15.2. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

15.3. Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administrator detyrohet:

15.3.1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;  
ç) të parandalojë dhe menjëherë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

15.3.2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

15.3.3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë dëm, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kerkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjet ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

15.4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë dëm të shkaktuar, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesat apo dividende;

c) u shpërndan aktivitet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi të paguara për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

15.5. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditesit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe demshperblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesës padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **KREU IV**

### **Viti financiar-ekspert**

#### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

16.1. Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti I parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

## **Neni 17**

### **Ekspertet**

17.1. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përfaqëson raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollin periodik të ushtruar, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **KREU V**

### **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

## **Neni 18**

### **Prishja dhe likuidimi**

18.1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

a) kur mbaron kohe zgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar përzullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

18.2. Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

18.3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

18.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

18.5. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## **Neni 19**



### **Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja**

19.1. Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**

20.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

20.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

#### **Ortaket Themelues:**

**BENISA KAÇE**

**ROENA POLENA**

**SOTIEL SAM POLENA**

*Roena Polena*

*Sotiel S. Polena*

